



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**



**V E N D I M**

**Nr. 70, datë 30.10.2017**

**PËR NJË PLOTËSIM TË VKB NR 89, DATË 17.10.2013 “PËR MIRATIM SHPRONËSIMI PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTËSHME, PRONË PRIVATE QË PREKEN PËR EFEKT TË INVESTIMIT PUBLIK TË OBJEKTIT RIKONSTRUKSIONIN E RRUGËS SHKODËR-SHIROKË DHE SHESHI I SHIROKËS”**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 30.10.2017, me propozim të kryetarit të bashkisë, mbështetur në nenet 9 pika 1.2 shkronja “b”, 54 shkronja “dh”, 55 pika 3, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar, VKM nr. 127, datë 23.3.2000 “Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, VKM nr. 89, datë 3.2.2016 “Për miratimin e vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, VKB nr. 89, datë 17.10.2013, shkresën nr. 361/1 prot, datë 30.1.2014 të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, shkresën nr. 3140 prot, datë 27.5.2015 të Bashkisë Shkodër “Kërkesë për shpronësim”, shkresën nr. 3141 prot, datë 27.5.2015 të Bashkisë Shkodër “Argumentimi ligjor”, shkresën nr. 3759/1 prot, datë 23.6.2017 të Ministrisë së Punëve të Brendshme, shkresën nr. 5045/2 prot, datë 6.9.2017 të ZVRPP Shkodër, me 34 vota pro,

**V E N D O S I :**

1. Të miratojë vlerën e shpronësimit të sipërfaqes prej 175 m<sup>2</sup> (njëqind e shtatëdhjetë e pesë) që preket nga investimi publik “Rikonstruksion Rruga Shkodër-Shirokë dhe sheshi i Shirokës”, në vlerën 1,489,425 lekë (një milion e katërqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e njëzet e pesë) dhe pasqyrën bashkëngjitur.
2. Burimi i financimit në vlerën prej 1,489,425 lekë do të jetë buxheti i bashkisë Shkodër i vitit 2018, Programi 6260 “shërbime publike vendore” Artikulli 231 “shpenzime për ritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara”.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet kryetari i bashkisë.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miratuar në datën 30.10.2017  
Shpallur në datën 31.10.2017

**Sekretar i këshillit**



**Suel Hadri**

**KRYETAR**

  


**Xhemal BUSHATI**